

Belogent



Belogent pomadë

Principi aktiv:– betamethasonum 0.5 mg, gentamicinë 1mg

Sasia: 15 gr

Përbërja sasiore dhe cilësore e produktit:

-1 g pomadë përmban 0.5 mg betamethasonë në formën e dipropionatit dhe 1 mg gentamicinë në formën e sulfatit

Indikacionet terapeutike

Sëmundjet e lekurës të cilat përgjigjen ndaj terapisë lokale me kortikosteroidë të cilët janë ose mund të zhvillohen si pasojë e infeksioneve bakteriale. Sëmundjet alergjike dhe joalergjike të lëkurës së infektuar: Tipet akute, subakute edhe kronike të dermatitit alergjik dhe profesional, dermatitis seborrheic, dermatitis atopik, intertrigo, dermatitis ekzematоз, dermatitis dishidrotik, dermatiti akut joalergjik pyodermatoz, fotodermatiti akut, dermatitis nga rrezatimi rontgen, dermatitis i infektuar ose shkaktuar nga pickimet e insekteve. Dermatozat e infektuara si psoriasis vulgaris, dermatitis exfoliativ, lichen ruberplanus.

Belogenti pomadë përdoret në dëmtimet e lëkurës së infektuar nga baktere të ndjeshme ndaj gentamicinës si: disa shtame të streptokokëve, staphylococcus aureus dhe bakteret gram-negative: Pseudomonas aeruginosa, Aerobacteraerogenes, E.Coli, Proteus vulgaris dhe Klebsiella pneumonia

Metoda e administrimit

Pomada është më e efektshme në trajtimin e dermatozave kronike si ; dëmtimet e thata të lichenifikuara dhe me luspa si në rastet kur nevojitet efekti bllokues i pomadës. . Sasia e nevojshme e pomadës aplikohet në lëkurën e prekur në një shtresë të hollë dhe i shpërndarë butësisht dy herë në ditë. Në zonat e lëkurës të trasha dhe shtresën korneale dhe në të cilat preparati eliminohet lehtësisht trajtimi duhet të bëhet më shpesh. Trajtimi nuk duhet të zgjasë më shumë se 3 javë. Në gjendjet kronike, për të parandaluar rikthimet, trajtimi duhet të vazhdohet dhe për ca kohë pas largimit të të gjitha shenjave, nën vëzhgimin e hollësishëm të mjekut.

Kundërrindikimet

Nuk duhet të përdoren në pacientët hipersensitivë ndaj betamethasonë, gentamicinë dhe të cdo përbërësi tjetër. Gjithashtu preparati nuk duhet të përdoret në tuberkulozin e lëkurës, vaksinat, varicela, dermatitis perioral dhe rosacea.